



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 07.04.2017



Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovi

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën: 29.03.2017

1. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake
2. Rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve
3. Vendim për mbeshtetje më mjete financiare Qendrën për Rehabilitim "Handikos" –dega në Drenas
4. Vendim për financimin e projektit KH "Drenica" (M)
5. Vendim për financimin e projektit FC "Feniksi"
6. Vendim për financimin e projektit KV "Gryka" (F)
7. Vendim për financimin e projektit SHKA "Shotë Galica"
8. Vendim për financimin e projektit KV "Drenasi" (F)
9. Vendim për financimin e projektit KF "Gryka"
10. Vendim për financimin e projektit Klubi i Boksit "Drenasi"
11. Vendim për financimin e projektit KH "Drenica" (F)
12. Vendim për financimin e projektit KF "Feronikeli"
13. Vendim për financimin e projektit KV "Drenasi"(M)
14. Vendim për financimin e projektit KVRL
15. Rishqyrtimi i vendimit për emertim të rrugëve
16. Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e shkollës në Komoran

Më datën 07.04.2017
Drenas




**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit(Gllogoc)**

Kuvendi i Komunës
01 Nr. 081-19551 dt. 07.04.2017



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z. Naim Bazaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 29.03.2017

1. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake
2. Rregullore për kushtet,kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve
3. Vendim për mbeshtetje më mjete financiare Qendrën për Rehabilitim "Handikos" dega në Drenas
4. Vendim për financimin e projektit KH,,Drenica" (M)
5. Vendim për financimin e projektit FC,,Feniksi"
6. Vendim për financimin e projektit KV „Gryka" (F)
7. Vendim për financimin e projektit SHKA „Shotë Galica"
8. Vendim për financimin e projektit KV,, Drenasi " (F)
9. Vendim për financimin e projektit KF,, Gryka"
10. Vendim për financimin e projektit Klubi i Boksit „Drenasi"
11. Vendim për financimin e projektit KH „Drenica" (F)
12. Vendim për financimin e projektit KF"Feronikeli"
13. Vendim për financimin e projektit KV,,Drenasi"(M)
14. Vendim për financimin e projektit KVRL
15. Rishqyrtimi i vendimit për emertim të rrugëve
16. Vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e shkollës në Komoran

Më datë 07.04.2017

Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Gllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400 - 18579 dt 05.04. 2017



Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 29.03.2017 miratoi këtë:

VENDIM
PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017. Mjetet për bartje janë të hyrat vetanake të pashpenzuara gjatë vitit të kaluar.

Neni 2

Të hyrat vetanake të pashpenzuara e që duhet të bartën janë në shumë prej: **514,668.75 €**

Neni 3

Shuma e mjeteve për bartje nga neni 2 i këtij vendimi do të shpenzohen në këto kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve dhe në këto programe – nënprograme të komunës :

I . Paga dhe Mëditje:

- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale (730), në nën- programin (73100) kodi funksional 0721 Kujdesit Primar Shëndetësor, me nën kategorit si vijon:
- 11500 – Tatimi i ndalur në burim në të ardhurat personale, shuma prej:455.13 €
- 11600 – Kontributi pensional nga punëtori, shuma prej:427.07€
- 11700 – Kontributi pensional nga punëdhënësi, shuma prej:427.07€
- 11115 – Pagesa për sindikata, shuma prej:65.44 €
- 11110 – Paga neto për listën e pagave:7,593.29 €
- Gjithsejtë Paga dhe Mëditje :8,968.00 €

II Mallra dhe Shërbime:

- Zyra e Kryetarit (160) nën – program (16001),kodi funksional 0111 në nën kategorit:
- 13420 – Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës), në shumë prej:1,337.38 €;
- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale (730) –nënprogramin (73100) me nën kategorinë 0721 Kujdesit Primar Shëndetësor , në nën kategoritë si vijon:
 - 1. 13950 – Regjistrimi i automjeteve në shumë prej:1,050.00 €
 - 2. 13951 – Sigurimi i automjeteve në shumë prej:2,135.65 €
- Drejtorati për Arsim (920), nënprogrami (92210) kodi funksional 0911 në nën kategoritë si vijon:
 - 1. 13610 – Furnizim për zyrë (material didaktik) në shumë prej:2,600.00 €
 - 2. 13620 – Furnizim ushqim dhe pije, në shumë prej:2,843.77 €
 - 3. 13770 – Derivate për gjenerator, në shumë prej:120.00 €

4. 14050 – Mirëmbajta e mobileve dhe paisjeve në shumë prej:	1,200.00 €
5. 13951 – Sigurimi i automjeteve në shumë prej:	636.00 €
6. 13950 – Regjistrimi i automjeteve në shumë prej:	225.00 €
<u>Gjithsejtë Mallrat dhe Shërbimet shuma prej:</u>	<u>12,147.80 €</u>

III. Shpenzime Komunale:

- Drejtorati për Administratë dhe Personel (163) , nën –programi (16301), me kod funksional 0133 në nën kategorinë e shpenzimit 13210 me shumë prej:.....1,41 €

IV. Subvencione dhe Transfere (Nga fondi burimor 21 dhe 22) :

-Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë (180), nën-programi (18001), me kod funksional 0451 në nën kategorinë 21200: – Subvencionet për Etnitetet Jopublike, në shumë prej:.....1,371.95 €

-Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik (470), nën- program (47001), kod funksional 0421 në nën kategorinë 23110 – Pagesa për sektor të blegtorisë, në shumë prej:1,371.95 €

-Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (730), nën-programi (73010) me kodin funksional 0760, në nën kategorinë 21200- Subvencionet per Entitete Jopublike, ne shumë prej:.....1,460.43 €

Gjithsejtë Subvencione dhe Transfere:4,204.33 €

IV. Shpenzimet Kapitale:

- Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinor (660),nën-programi (66310),kodi funksional 0620 bartjen e mjeteve do t'a shpenzojë në këto projekte kapitale,në shumë prej:..... **489,347.21 €**
 - Kodi i projektit (89091 në nën kategorinë (31230 – Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec (L. Hajdari, Shehu dhe Ademi), në shumë prej: 38,106.00 €,
 - Kodi i projektit (89027), në nën kategorinë (31230 Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi Abri e Epërme (L. Hajdari, Hysenaj,Muliqi dhe Asllani), në shumë prej:56,838.00 €,
 - Kodi i projektit (89026), në nën kategorinë (31230- Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës Paklek i Ri, në shumë prej: 22,744.96 €,
 - Kodi i projektit (43005), në nën kategorinë (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik, në shumë prej:38, 159.00 €,
 - Kodi i projektit (43007), në nën kategorinë (31230- Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës Tersteniku II, L. Arllati, Mulaj, Munishi, në shumë prej: 17,505.00 €,
 - Kodi i projektit (89029), në nën kategorinë (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) - Asfaltimi i rrugës në qytezen e Komoranit, në shumë prej:60,000.00 €,
 - Kodi i projektit (89093), në nën kategorinë (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në Verboc, në shumë prej:.....4,000.00 €
 - Kodi i projektit (43013), në nën kategorinë (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës Llapushnik L. Sopi, në shumë prej:50,000.00 €
 - Kodi i projektit (89085), në nënkategorinë (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në fshatin Likoshan, në shumë prej:50,000.00 €
 - Kodi i projektit (89039), në nën kategorinë (31250 – Kanalizim) – Ndertimi i kanalizimit në fshatin Baicë, në shumë prej: 30,000.00 €
 - Kodi i projektit (43018), në nën kategorinë (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Ndërtimi i urës në Drenas III, rruga Drenas – Baicë, në shumë prej:.....60.000.00€
 - Kodi i projektit (43008), në nën kategorinë (31250- Kanalizim) – Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Gilanasell, në shumë prej:6,500.00 €,
 - Kodi i projektit (43020), në nën kategorinë (31250 – Kanalizim) – Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Abri, në shumë prej;20,000.00 €,
 - Kodi i projektit (89096), në nën kategorinë (31110 – Ndërtesat e banimit) – Ndërtimi i shtëpive skamnore, në shumë prej:10,000.00 €,

- Kodi i projektit (89036) në nën kategorinë , (31230 - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në fshatin Gjergjicë, në shumë prej:25, 141.00 €.

- Drejtorati për Arsim (920) – nënprogrami Arsim – Administratë kodi (92005)në program 0980 – bartjen e mjeteve do t'i shpenzoj në këtë projekt kapital.

- Kodi i projektit (89143 në nën kategorinë (31129 – Fushat Sportive) – Rregullimi i fushës sportive në SHFMU “Zenel Hajdini” – Terstenik I, në shumë prej:353.25 €

Gjithsejtë Shpenzimet Kapitale489,347.21 €

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset; Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe autorizuesit e programeve – nënprogrameve të buxhetit të komunës .

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja 15 dite pas regjistrimit në zyren e protokollit të ministrisë përgjegjëse për veteqëverisje Lokale si dhe publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Naim Bazaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)

Kuvendi i Komunës



Me Nr. 326 - 19338 dt 07.04. 2017

Duke u bazuar ne nenin 12 dhe 40 të ligjit nr.03/L-040, nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 34.6, të Statutit të Komunës së Glogocit (Drenas) Kuvendi i Komunës se Drenasit ne mbledhjen e mbajtur me dt,29.03.2017 miratoj këtë:

RREGULLORE

PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullorë kanë këtë kuptim:

1.1 Subvencionet - për kuptim të kësaj rregullore subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik

1.2 Pagesa e pakthyeshme - është e njëanshme atëherë kur nuk ka malira dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

1.3 Përfituesi - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuar në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.

1.4 Banor rezident - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 3 Limitet buxhetore

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfshues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencione

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të vecanta në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet 20 ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 6

Përfatshimet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfatues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfatues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përfatshim nga paragrafi 2 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe për nevoja ushqimore (mirëqenia sociale).
4. Nëse me fajin e përfatuesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 (tre) vitet e ardhshme përfatuesi humb të drejtën në përfatim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfatësuesve nga fushat specifike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës.
3. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil të Komunës.
4. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 5 (pesë) anëtarëve, njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave dhe një anëtarë duhet të jetë nga shoqëria civile që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencionit.
5. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

6. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bënë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
5. Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe i rekomandon marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve. .
6. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me rekomandim të Komisionit
7. Komuna i njofton sa më shpejt që është e mundur të gjithë aplikuesit në baza individuale për përfshirjen ose jo në listën e përfituesve të subvencioneve dhe i njofton për të drejtën dhe procedurën e parashtrimit të ankesës

8. Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve
9. Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione me mandat tre vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfqësuesve nga fushat specifike.
2. Kryetari dhe anëtarët të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil
3. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
5. Një anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor i njësisë përkatëse.
6. Anëtarë të Komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
7. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

Neni 10

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

1. Ankesa parashtrohet në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas njoftimit të vendimit të Kryetarit të Komunës për mos ndarjen e subvencioneve.
2. Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.
3. Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 11

Ekzekutivshmëria e vendimit

1. Vendimi i Kryetarit për ndarjen e subvencioneve bëhet i ekzekutueshëm nëse:

1.1. nuk është paraqitur ankesë sipas paragrafit 1 të neni 12,

1.2. me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa.

Neni 12

Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve

1. Procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në ueb faqen e komunës, mediat lokale, mediat sociale vendet e frekuentuara si dhe në çdo mjet dhe vend tjetër të përshtatshëm.
2. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar ndarjen e subvencioneve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregullore
3. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë pune nga data e shpalljes.

Neni 13

Marrëveshja për subvencionim

1. Për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit.
2. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.

Neni 14

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. bursa për student;
 - 1.2. bursa për nxënës në shkollë të mesme;

- 1.3. bursa për nxënës në shkolla fillore;
 - 1.4. kuadrot deficitar;
 - 1.5. nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 1.6. gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
 - 1.7. botimin e librave/ revistave;
 - 1.8. nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 1.9. mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal.

Neni 15

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë përcakton kriteret të garta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në :
 - 1.1. Notën mesatare;
 - 1.2. Numri i studentëve/ nxënësve në familje;
 - 1.3. Kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë);
 - 1.4. Banimi në zona rurale;
 - 1.5. Rezultatet në gara;
 - 1.6. Gjendja ekonomike.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Dokumenti i identifikimit;
 - 2.2. Certifikata e notave;

- 2.3. Certifikata e vitit kalendarik të studimeve;
- 2.4. Certifikatë e vendbanimit;
- 2.5. Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;
- 2.6. Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
- 2.7. Dëshmi për rezultatet në gara;
3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfshues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfshues i një burse të ndarë nga pusheti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë
4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.

Neni 16

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1 Zejret tradicionale;
 - 1.2 Aksesore;
 - 1.3 Agrobizneset;
 - 1.4 Teknologji Informative;
 - 1.5 Ndërmarrjet publike;
 - 1.6 Biznese inovative;

1.7 Ndërmarrje sociale;

1.8 Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;

1.9 Inkubatorët e biznesit;

1.10 "Start-up" bizneset;

1.11 Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njëzëzore për zhvillim të biznesit;

1.12 Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.

2. Përfutjes të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunë.

3. Përfutjes të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Nëni 17

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

1.1. Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbuese që gjenerojnë punësim;

1.2. Grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevojë të veçantë dhe komunitetet;

1.3. Bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta prej 50% (*vlera minimale = 10.000€*) të vlerës;

1.4. Bizneset të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale.

- 1.5. OJQ-të të cilët aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës.
- 1.6. Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfshirë në një subvencion për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.
2. Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për e subvencione- për zhvillim ekonomik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Plan i biznesit;
 - 1.2. Dokumenti identifikues;
 - 1.3. Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
 - 1.4. Certifikata e biznesit;
 - 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj A TK-së;
 - 1.8. Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);
 - 1.9. Konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit;

Neni 19 Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
 - 1.2. organizimin e panaireve, seminareve, vizitave studimore;
 - 1.3. mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
 - 1.4. projekteve në sektorin e pylltarisë.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:
 - 2.1. Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
 - 2.2. Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim prej 50% (*vlera minimale 5.000€*) të vlerës, me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
 - 2.3. Grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe minoritetet;
 - 2.4. Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtit fiskal nuk kanë qenë përfshirë në një subvencion për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 20

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:

- 1.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
- 1.2. Certifikata e biznesit;
- 1.3. Projekti dhe plani financiar;
- 1.4. Fletëposedim për patundshmëri;
- 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
- 1.8. Konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit;
- 1.9. Dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit.
- 1.10. Dëshmi se nuk është përfutës i një subvencionit të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda viti fiskal.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 2.2. Projekti dhe plani financiar;
 - 2.3. Fletëposedim për patundshmëri të mirret për bazë Certifikata Noteriale dhe Certifikata e vdekjes
 - 2.4. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 2.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 2.6. Konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit;

Neni 21

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për përballimin e shpenzimeve të shërimin sipas kriterëve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.
2. Subvencionet për shëndetësi jepen për:
 - 2.1. rastet e rënnda shëndetësore;
 - 2.2. rastet e sëmundjeve jo të rënnda por pa burim të të ardhurave;
 - 2.3. trajtimin jashtë vendit;
 - 2.4. lehonat;
 - 2.5. fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;
 - 2.6. mirëqenie sociale.
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 3.1. Numri i anëtarëve të familjes;
 - 3.2. Çështja e barinut;
 - 3.3. Kostoja e trajtimit;
 - 3.4. Gjendja ekonomike familjare;
 - 3.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi nga personat fizik përfaqësojnë, duke mos u kufizuar:
 - 4.1. Diagnoza e mjekut specialist;
 - 4.2. Dokumenti i identifikimit;

4.3. Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit;
4.4. Dëshmia e shpenzimeve njëkësore.

4.5. Personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpalje publike por me kërkesë të arsyetuar

Neni 22 Subvencionet për kulturë, rinë, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rinë dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1. Klubet sportive
- 1.2. Sportistët e dalluar
- 1.3. Garat sportive
- 1.4. Shoqëritë amatore (ansamblet)
- 1.5. Teatrot amatore
- 1.6. Festivalet
- 1.7. Botimi i librave
- 1.8. Ekspozitat me fotografi
- 1.9. Aktivitete me karaktere garuese
- 1.10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
- 1.11. Promovim i librave
- 1.12. Promovim i talentëve të rinj
- 1.13. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
- 1.14. KVR
- 1.15. Qendra Rinore

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

- 2.1 Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
- 2.2 Projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
- 2.3 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfutës i një subvencionit për kulturë, rim, sport të ndarë nga pusheti qendror ose nga ndonjë donator tjetër
3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 3.1 Projekt propozimi;
 - 3.2 Aplikacioni;
 - 3.3 Dokumenti identifikues;
 - 3.4 Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
 - 3.5 Certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
 - 3.6 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 3.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
 - 3.8 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
 - 3.9 Konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit;

Neni 23

Raportet kthyesë nga përfutësit e subvencioneve

1. Përfutësit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
2. Përfutësit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet të jetë gjithë shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.).

3. Përfutuesit e subvencioneve obligohen që pas përfutimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfutuese dhe komunës apo në vendimin e Kryetarit të Komunës
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 24

Monitorimi i përfutuesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfutuesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.
2. Komuna iniciuon dhe bënë monitorimin e përfutuesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfutuesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfutimit të subvencionit.

Neni 25

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

1. Komuna publikon listën përfundimtare të përfutuesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.

2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbaj: emrin e përfitësit, rasin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shumat që iu janë ndarë
